

VENDIM
Nr. 474, datë 15.6.2020

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2020,
PËR MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, dhe të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime operative” të programit buxhetor 01140 “Menaxhimi i të ardhurave tatimore”, i shtohet fondi prej 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekësh, për rimbursimin e gjobave të vëna nga autoritete të shteteve të huaja, shtetasve shqiptarë të cilëve iu përfundonte afati i qëndrimit në periudhën 10 mars–1 qershor 2020 dhe, për shkak të mbylljes së kufijve si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga COVID-19, kanë tejkaluar afatin e qëndrimit në këto shtete.

2. Efekti financiar prej 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2020.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, pas paraqitjes së mandatit të arkëtimit që vërteton pagesën e gjobës, të përkthyer e të noterizuar, kryen rimbursimin e gjobës në të njëjtën masë (ekuivalente në lekë) në llogarinë bankare të përcaktuar nga individit përfitues.

4. Në rast dyshimi apo konstatimi të një parregullsie në dokumentet e paraqitura për rimbursim të gjobës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve kërkon informacion në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrinë e Brendshme.

5. Shuma e papërdorur e fondit, sipas pikave 1 e 2 të këtij vendimi, kthehet në fondin rezervë të buxhetit të shtetit, të miratuar për vitin 2020.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama